



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*  
*Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister*

*Prishtinë 16 Maj 2018*

**Thirrje publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve të OJQ-ve që vijnë nga komuniteti malazet dhe kroat që merren me afirmimin dhe integrimin e këtyre komuniteteve që jetojnë në Republikën e Kosovës**

**1. Zyra e Kryeministrit u bënë thirrje të gjitha organizatave jo-qeveritare të Regjistruara në Republikën e Kosovës, që vijnë nga komuniteti malazet dhe kroat që merren me afirmimin dhe integrimin e këtyre komuniteteve që jetojnë në Republikën e Kosovës.**

2. OJQ-të në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projektete tyre për fushat prioritare në vijim:

- 1. Integrimi i komuniteteve malazet dhe kroat në shoqërinë kosovare*
- 2. Avancimi i pozitës së këtyre komuniteteve në shoqëri*

3. Organizatat jo- qeveritare mund të aplikojnë me një projekt që kontribuojnë nëpërfshirja e tyre në shoqëri. Përmes aktiviteteve si më poshtë:

- ✓ Aktivitete që synojnë për integrimin e komuniteteve malazet dhe kroat nga fushat prioritare të thirrjes publike;

- ✓ Aktivitetet që kanë për qëllim përfshirjen e komuniteteve malazez dhe kroat në shoqërinë kosovare në fusha të ndryshme të jetës;
- ✓ Aktivitete që synojnë ngritjen e vetëdijesimit të pjesëtarëve të komuniteteve malazez dhe kroat në fushën e mbrojtjes e të drejtave të minoriteteve;
- ✓ Aktivitete organizimi i aktiviteteve trajnime, tryeza, seminare për ata që operojnë në fushën e të drejtave të komuniteteve;
- ✓ Aktivitetet që synojnë për përmirësimin e kushteve për një jetë më të favorshme në shoqëri.

4. Vlera totale e planifikuar e thirrjes është 80,000 euro. 40,000 euro do të ndahen për organizatat jo qeveritare që vijnë nga komuniteti malazez që jetojnë në Republikën e Kosovës dhe 40,000 euro të ndahen për organizatat jo qeveritare që vijnë nga komuniteti kroat që jetojnë në Republikën e Kosovës.

Shuma maksimale e financimit për një projekt do të jetë 40,000 euro. Përmes kësaj thirrje do të financohen dy Organizata jo qeveritare, nga një organizatë jo qeveritare e komunitetit malazez dhe një organizatë jo qeveritare e komunitetit kroat.

5. Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë pune dhe përfundon me datën 06.06.2018.

6. OJQ-të mund të aplikojnë me më së shumti një (1) projekt në kuadër të kësaj thirrje. Periudha e zbatimit të projektit është një vit.

Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave jo-Qeveritare në Republikën e Kosovës dhe të cilat veprojnë në Republikën e Kosovës së paku *një (1) vit* para datës së publikimit të thirrjes publike. OJQ-të aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në ndonjërin nga fushat prioritare të thirrjes publike. OJQ-të duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale *ndaj ofruesit të mbështetjes financiare* dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike.

Para nënshkrimit të kontratës, OJQ duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe prova se OJQ-ja

kazgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatatimeve të papaguara, nëse është e aplikueshme.

7. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit të *Zyrës së Kryeministrit*

Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen me postë ose personalisht, në adresën e mëposhtme:

*Zyra e kryeministrit, Sheshi Nënë Tereza, N.n, 10000, Prishtinë,*

Procesi i pranimi, hapjes dhe shqyrtimit aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendarin tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në *Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike.*

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

8. Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: [Keriman.Sadikay@rks-gov.net](mailto:Keriman.Sadikay@rks-gov.net)